



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 892 Prot.

Roskovec, më 03, 10 2022

VENDIM

NR. 75 . DATË 30.09 .2022

“PËR PËRDITËSIM NË LISTËN E INVENTARIT ,MIRATUAR ME VKM-NË NR.1210,DATË 11.12.2009 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,SHTETËRORE QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË KOMUNËS KUMAN,QARKU FIER DHE VKB-SË NR.50 DATË 29.06.2020 “PËR PËRDITËSIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTESHME SHTETËRORE QË NDODHEN NË TERRITORIN E NJËSISË ADMINISTRATIVE KUMAN,BASHKIA ROSKOVEC”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 54, gërma k) ; Ligjit Nr.8743, datë 31.07.2000 për “Pronat e paluajtshme të shtetit” (i ndryshuar) ; Ligjit Nr. 8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 3, datë 18.07.2002 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga njësitë e qeverisjes vendore”, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Përditësimin e Listës së Inventarit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kuman ,Bashkia Roskovec të miratuar me VKM-në nr.1210 datë 11.12.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të **Komunës Kuman** , Qarku Fier" dhe VKB-së Nr.50,datë 29.06.2020 “Për përditësimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Kuman,Bashkia Roskovec”
2. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Bashkëlidhur këtij vendimi:

- Planvendosja për pronën
- Formulari për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore

